

Aksidentet rrugore 2017 dhe krahasimi me vitin 2016.

Aksidentet rrugore 2016-2017.

Nga vëzhgimet vërejmë se viti 2017 është karakterizuar nga intensitete me ulje dhe ngritjet e veta në trafikun rrugor. E pasqyruar kjo në shifra të cilat janë në momente të caktuara premtuese dhe flasin për një tendenca pozitive.

Duhet theksuar se ka patur stabilizim të sigurise rrugore, disa ndryshime në dukje premtuese në sjelljet e drejtuesve të mjeteve e perdoruesve të rrugës në trafik. Ndryshimet ligjore kanë sjelle përmirësimet e para të prekshme në perdorimin e rripit të sigurisë, ulje të përdoruesve të alkolit gjatë drejtimit të mjetit, rritje të përdorimit të sediles së posacme për femijët gjatë levizjes me mjete motorike.

Ekseprienca e deritashme e marrë edhe si pervojë me treguesit e saj, krahas sensibilizimt, kërkon me ngutje ndryshime ligjore që forcojnë masat ndëshkuese për drejtuesit e mjeteve që përdorin celular gjatë ngarjes së mjeteve motorike.

Mos harrojmë se nga aksidentet rrugore vendi ynë gjatë dekadës së fundit ka humbur mesatarisht 300 jetë njerëzish çdo vit.

Në trafik nuk jemi vetëm, të gjithë qarkullojmë me mënyra e mjete të ndryshme. Është koha kur së bashku duhet të hedhim çdo ditë hapat e duhura të cilat rrisin sigurinë në rrugët tona.

Shpejtësia dhe sjellja agresive në pesë vitet e fundit të marra së bashku, janë shkak i 29% të vdekjeve dhe 32% të plagosjeve.

Nga viti 2016 dimë se janë përfshirë në aksidente 719 persona ku 269 kanë humbur jetën, 59,8 prej tyre kanë ndodhur në zonat urbane. Të gjitha këto për shkaqe të njohura, tejkalim shpejtësië, kalim i pakujdesshëm i rrugës, moszbatim i sinjalistikës rrugore, etj.

Për muajin korrik 2017 numërohen 199 aksidente , me një rritje 7,6 përqind krahasuar me vitin 2016.

Në këto aksidente janë lënduar 272 persona nga 281 që ka qënë një vit më parë. Numëri i personave të vdekur është 22, duke qënë 1,9 % më pak se 2016. Nga këto 81,9 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve..

Po kështu në gjashtëmujorin e parë 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit zënë 79,9 % të rasteve.

Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 25 – 35 vjeç, duke zënë 28,3 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke shënuar ulje 9,3 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më pare

Sipas raportimeve të Policisë Rrugore nga periudha Janar – Nëntor 2017 krahasuar me periudhën Janar – Nëntor 2016 shifrat paraqiten si më poshtë:

Aksidentet rrugore sipas qarqeve Janar - Nëntor 2016-2017

Periudha	Aksidente		Të vdekur	
	Janar –Nëntor 2016	Janar –Nëntor 2017	Janar- Nëntor 2016	Janar –Nëntor 2017
Shqipëria	1545	1845	243	206
Tirana	686	731	60	50
Durrësi	227	241	33	26
Shkodra	117	44	23	21
Elbasani	145	145	16	16
Fieri	133	110	21	27
Vlora	89	132	12	10
Korca	129	97	20	12
Lezha	177	194	25	24
Kukësi	45	41	5	1
Dibra	29	35	9	1
Gjirokastra	29	34	13	11

Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 25–35 vjeç, duke zënë 27,9% të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke u ulur me 4,1%, me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri më i lartë i aksidenteve ka ndodhur në qarkun e Tiranë ku kanë humbur jetën 9 persona.

Këtë muaj kanë qene problematikë Durrësi dhe Fieri kryesisht për jetët e humbura. Edhe pse qeveria shqiptare i ka forcuar masat ndëshkuese për drejtuesit e mjeteve sërish ata mbeten shkaku kryesor i aksidenteve në vend.

Të dhënat zyrtare të Institutit të Statistikave tregojnë se në qershor rezultojnë 185 aksidente me një rritje 2.2 % krahasuar me qershor 2016.

Por në të kundërt ka qenë tendenca e të aksidentuarve. Ky numër është ulur me 4.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të njëjtin trend ka pasur edhe pjesa e aksidenteve me pasojë vdekjen e personave të përfshirë.

Në qershor rezultojnë 12 persona që kanë humbur jetën nga aksidentet një shifër kjo 46.4% më e ulët se i njëjti muaj i një viti më parë.

Të rinjtë mbeten kontingjenti që ka kryer edhe numrin më të lartë të aksidenteve.

“Në Qershor, aksidentet rrugore, në 73,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup moshë 16 – 25 vjeç duke zënë 24,3 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke u rritur me 66,7 %, krahasuar me një njëjtën periudhë të një viti më parë”, vlerëson INSTAT.

Po kështu në gjashtëmujorin e parë 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit zënë 79,9 % të rasteve.

Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup moshë 25 – 35 vjeç, duke zënë 28,3 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke shënuar ulje 9,3 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë

Në qershor 2017, numri i të aksidentuarve për 100.000 banorë ishte afërsisht 8 persona. Krahasuar me mesataren e vitit 2016, ky tregues u rrit me 5,8 %.

Problem mbetet tipi i aksidentit mjet-këmbësorë për të cilën shkaktojnë janë si drejtuesit e mjeteve ashtu edhe vetë këmbësorët që nuk respektojnë sinjalistikën rrugore.

Po ti referohemi një viti më parë kemi patur 269 të vrarë, pra aksidente fatale, dhe tipi i aksidentit, mjet / këmbësorë ka në këtë tregues fatal, 85 raste.

Po të vëzhgojmë sjelljet e shoferëve për këto 264 raste fatale, kemi 39 raste për ndryshim të papritur drejtimi, e 57 për shpejtësi të lartë.

Sjellja e këmbësorit është ende mjaftë problematike; në 264 raste 57 janë për kalim të pakujdesëm rrugë.

Në total moszbatimi i rregullave të qarkullimit, befasi, pakujdesi, kalim rrugë në vendin e gabur kapin 63,3 % të rasteve.

Në muajin nëntor, të këtij viti numri i aksidenteve rrugore dhe personave që kanë humbur jetën prej tyre ka patur është rritje.

INSTAT ka bërë me dije se në muajin nëntor 2017 janë numëruar 177 aksidente rrugore, nga 152 aksidente të ndodhur në nëntor 2016 me një rritje 16,4 %.

Numri i të aksidentuarve është 235 persona, nga 197 që ishte një vit më parë, për të njëjtën periudhë.

Ndërkohë në 11-mujorin e 2017, numri i të aksidentuarve është ulur 4,3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Numri i personave të plagosur gjatë muajit Nëntor 2017 është 215, nga 182 persona të plagosur në Nëntor 2016.

Krahasuar me mesataren e personave të plagosur gjatë vitit 2016, ky numër është rritur me 2,8%. Në nëntor, aksidentet rrugore, në 79,1% të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit.

Në 11-mujorin e 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit zënë 81,3% të rasteve.

Numri më i lartë i aksidenteve ka ndodhur në qarkun e Tiranë ku kanë humbur jetën 9 persona.

Të vdekur sipas qarqeve në periudhën Janar-Nëntor 2016-2017



Si pasojë e kësaj situatë, Shqipëria edhe pse ka numrin më të ulët të automjeteve për frymë, ka nivelin më të lartë të aksidente për 1 mijë banorë në rajon.


Numeri i aksidenteve rrugore dhe personave qe kane humbur jeten prej tyre eshte rritur ne menyre te ndjeshme ne muajin nentor te ketij viti, 2017-tes.

Sipas te dhenave zyrtare te INSTAT, ne netor te ketij viti u regjistruan 177 aksidente rrugore, nga 153 te tilla qe kishim ne te njetin muja te 2016-tes.

Shohim nje rritje me 16,4%. Numeri i te aksidenturave eshte 235 persona, nga 197 qe ishin nje vit me pare, gjithnje per te njetin muaj, ate nentor.

Megjithate ne 11 mujorin e vitit 2017 numeri i te aksidentuarve ka persuar nje ulje prej 4,3 % krahasuar me nje vit me pare.

Aksidentet sipas qarqeve për periudhen Janar- Nëntor 2016-2017



Numëri i personave të plagosur gjatë muajt të nëntor 2017 është 215, nga 182 të plagosur që kishim në vitin 2016.

Krahasuar me mesataren e personave të plagosur gjatë vitit 2016, ky numer është rritur në 2,8 %.

Në nëntor aksidentet rrugore në 79,1% të rasteve kanë ndodhur për pasojë të jelljes së gabuar të drejtuesve të mjeteve motorike.

Në 11 mujorin e 2017-tës aksidentet rrugore të ndodhura për shkak të sjelljes së gabuar të drejtuesve të mjetit zënë 81,3% të rasteve.

Numëri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup- mosha 25-35 vjeç, duke zënë 27,9% të numërit të aksidenteve rrugore me një ulje prej 4,1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Numëri më i lartë i aksidenteve ka ndodhur në Tiranë, ku kane humbur jetën 9 persona.

Këtë muaj, pra nëntor, më problematik janë paraqitur Durrësi e Fieri, kryesisht për humbje jete.

Edhe pse ka patur një forcim të masave ndëshkuese për drejtuesit e mjeteve, shpejtesia mbetet serish shkaku kryesor i aksidenteve në vend.

Duhet theksuar se edhe pse Shqipëria ka numërin më të ulët të automjeteve për frymë, ende mban nivelin më të lartë të aksidenteve për një mijë banorë në rajon.